



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 & 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas për ri-aplikim të kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 - 240634/19 dt.01.10.2019, të kërkuësve / pronarëve, Nazmi Çitaku dhe Jashar Fazliu nga Prishtina, rr."Eqrem Qabej", BLL-III/9, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për ndërtimin e Kompleksi - **Lagjja "Green Hill"**, me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare – **33 shtëpi** të sipas tipeve: **"T1" – 6 shtëpi**, **"T2" – 15 shtëpi**, **"T3" – 5 shtëpi** dhe **"T4" – 7 shtëpi**, në kuadër të PZHU-së, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative me datë 27.01.2020, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuësve/pronarëve, Nazmi Çitaku dhe Jashar Fazliu nga Prishtina, rr."Eqrem Qabej", BLL-III/9, sipas kërkesës për ri-aplikimit për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 - 240634/19 dt.01.10.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e Kompleksi - **Lagjja "Green Hill"** me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare - **33 shtëpi** të Tipit: **"T1" – 6 shtëpi** me S+P, **"T2" – 15 shtëpi** me S+P, **"T3" – 5 shtëpi** me P+1 dhe **"T4" – 7 shtëpi** me S+P, në kuadër të PZHU-së, konkretisht parcelave kadastrale nr. 954-0, 955-0, 959-0 dhe 973-0 ZK Bërnice e Epërme, sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet dhe trajtohet sipas:

- *Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është e planifikuar me destinim "Ndërtim individual";*

Pronarët për kriteret dhe parametrat urban, si dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes shkresës "Informim nga Plani Zhvillimor Urban "Prishtina 2012-2022"-PZHU, 04nr.350/01 – 0307342/17 dt.22.12.2017", lëshuar nga DPSZHQ të Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelave kadastrale, nr. 954-0, 955-0, 959-0 dhe 973-0 ZK Bërnice e Epërme, sipas gjendjes kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
 - nr.954-0; S=1674m²; Nazmi Çitaku;..... "Livadh i klasit 2";
 - nr.955-0; S=897m²; Nazmi Çitaku, Jashar Fazliu;..... "Livadh i klasit 2";
 - nr.959-0; S=3946m²; Nazmi Çitaku, Jashar Fazliu;..... "Arë e klasit 4";
 - nr.973-0; S=13714m²; Nazmi Çitaku, Jashar Fazliu..... "Mal i klasit 4";
- Totali i parcelave të trajtuar: S=20,231.00m².**
- Mos harmonizimi i pjesëve grafike dhe tekstuale të parcelave kadastrale, gjegjësisht diferenca e tyre bazuar në matjet e gjendjes ekzistuese dhe prezantuar me manualin e gjendjes ekzistuese nga kompania gjeodezike:
 - nr.954-0; S=1669m²; / - 5m² /
 - nr.955-0; S=881m²; / - 16m² /
 - nr.959-0; S=3946m²; / 0.00m² /

- nr.973-0; S=13717m²; / +3m² /

Totali i diferencës: S=-18m².

- E drejta pronësore - juridike e parcelave kadastrale të lartcekura, është private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartë cekura, nuk ka ndërtesa - janë të zbrazëta;
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga ana veri - perëndimorë në drejtimin jug - lindor me një disnivel prej ~40m';
- Qasja në parcela të lartcekur është përmes rrugëve lokale të zonën;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m` nuk ka ndërtesa ekzistuese;

IV. Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” e Kompleksi - **Lagjja “Green Hill”** me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare si dhe me infrastrukturë përcjellëse, e analizuar, studiuar dhe trajtuar me kushte ndërtimore, është konceptuara zgjidhje me katër (4) tipe të shtëpive në kuadër të parcelave ndërtimore, janë:

a) **Tipi “T1”** - **6** shtëpi me / S+P /, me sipërfaqe totale, S=202.70m², të sistemuara nëpër etazhe: Suterani - S=95.58m² dhe Përdhësa - S=107.12m².

b) **Tipi “T2”** - **15** shtëpi me / S+P /, me sipërfaqe totale, S=189m², të sistemuara nëpër etazhe: Suterani - S=109m² dhe Përdhësa - S=80m².

c) **Tipi “T3”** - **5** shtëpi me / P+1 /, me sipërfaqe totale, S=234m², të sistemuara nëpër etazhe: Përdhës - S=124.37m² dhe Kati 1 - S=109.63m².

d) **Tipi “T4”** - **7** shtëpi me / S+P /, me sipërfaqe totale, S=153m² të sistemuara nëpër etazhe: Suterani me S=70.76m² dhe Përdhësa me S=82.24m².

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për ndërtimin e Kompleksi - **Lagjja “Green Hill”** me ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare sipas Tipit: “T1”, “T2”, “T3” & “T4” me infrastrukturë teknike përcjellëse, në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret dhe kushtet urbane, të cilat janë:

- Organizimi & qasja në kompleks - parcela ndërtimore, pozicionimi, gabaritet dhe etazhiteti i ndërtesave / shtëpive familjare, raporti i ndërtesave-shtëpive familjare me vijat rregulluese & ndërtimore, distanca nga kufiri i parcelave ndërtimore, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - “zgjidhja urbane” bashkangjitura vendimit kushteve ndërtimore;
- Sipërfaqet e parcelave kadastrale për organizimin / rregullimin e kompleksit, konkretisht të trajtuara në parcela ndërtimore - sipërfaqe brenda vijës rregulluese, për realizimin e kompleksit me ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare, janë:
 - nr.954-0; S=1154m²;
 - nr.955-0; S=872m²;
 - nr.959-0; S=2814m²;
 - nr.973-0; S=10280m²;

Totali i parcelave të trajtuara për parcela ndërtimore: S=15,120.00m².

- Parcelat kadastrale me sipërfaqe të trajtuara në hapësira publike - jashtë vijës rregulluese, të parcelave ndërtimore sipas Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” si rrugë e planifikuar për realizimin e kompleksit me ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare, janë:

- nr.954-0; S=515m²;
- nr.955-0; S=9m²;
- nr.959-0; S=1132m²;
- nr.973-0; S=3437m²;

Totali i sipërfaqeve të parcelave të trajtuara për infrastrukturë / rrugë: S=5,093.00m².

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të kompleksit, të jetë për banim individual / shtëpi familjare si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh, ndërtime në shërbim të kompleksit etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti sipas PZHU-së është I ÷ III etazhe mbi tokë, (sipas projekt propozimit dhe i miratuar, S+P & P+1);

- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore në kuadër të kompleksit (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë / gabarit të përdheses ose suteranit, sipas PZHU-së lejohet max.30%.

Kompleks i ndërtesave individuale / shtëpi familjare - Tipit: "T1", "T2", "T3" & "T4",

Tipi "T1":

$S=466 \times 0.3=139.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=577 \times 0.3=173.10\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T2":

$S=431 \times 0.3=129.30\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=702 \times 0.3=210.6\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T3":

$S=414 \times 0.3=124.20\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=600 \times 0.3=180\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T4":

$S=306 \times 0.3=91.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=447 \times 0.3=134.10\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë / gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në planin rregullues dhe paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, por sipas projekt propozimit, ndërtesat individuale banimore / shtëpi familjare nuk kanë bodrume.
- Në kuadër të parcelave ndërtimore të planifikohen edhe hapësira gjelbëruese (ISGJ) min.40%, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, bazuar në Vendim 01nr.110-391 dt.1.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, është:

Kompleks i ndërtesave individuale / shtëpi familjare - Tipit: "T1", "T2", "T3" & "T4",

Tipi "T1":

$S=466 \times 0.4=186.40\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=577 \times 0.4=230.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T2":

$S=431 \times 0.4=172.40\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=702 \times 0.4=280.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T3":

$S=414 \times 0.4=165.60\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=600 \times 0.4=240\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T4":

$S=306 \times 0.4=122.40\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=447 \times 0.4=178.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

- Koeficienti i ndërtimit të etazheve të mbi tokës (ISHD) sipas PZHU-së është $0.6 \div 0.8$ për parcelat ndërtimore, andaj trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleks i ndërtesave individuale / shtëpi familjare - Tipit: "T1", "T2", "T3" & "T4",

Tipi "T1":

$S=466 \times 0.6=279.60\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=466 \times 0.8=372.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=577 \times 0.6=346.20\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

$S=577 \times 0.8=461.60\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T2":

$S=431 \times 0.6=258.60\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=431 \times 0.8=344.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=702 \times 0.6=421.20\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

$S=702 \times 0.8=561.60\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T3":

$S=414 \times 0.6=248.40\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=414 \times 0.8=331.20\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /

$S=600 \times 0.6=360\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

$S=600 \times 0.8=480\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

Tipi "T4":

$S=306 \times 0.6=183.60\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /
 $S=306 \times 0.8=244.80\text{m}^2$; / lejuar për parcelën minimale /
 $S=447 \times 0.6=268.20\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /
 $S=447 \times 0.8=357.60\text{m}^2$; / lejuar për parcelën maksimale /

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së distanca dhe *"sipërfaqja e lirë përreth objektit duhet të pozicionohet në kuadër të "ngastrës"- brenda parcelës kadastrale, dhe për të siguruar dritë dhe ajër të mjaftueshëm"*, kjo sipërfaqe e lirë duhet të jetë $0.5 \times H$ (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), ose mes ndërtesave $1 \times H$, për të mundësuar ndriçim direkt të mjaftueshëm natyror, nëpërmjet hapjeve në fasadë për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore, etj), dhe kjo sipërfaqe e lirë duhet ti referohet kufirit të parcelës, e cila distancë e njëjtë do të vlejë edhe për hapësirën mes dy ndërtesave të kompleksit. Nëse sigurohet pëlqimi i vërtetuar nga pronari/pronarët e parcelave fqinje, kjo distancë mund të zvogëlohet apo mund të ndërtohet në kufi të parcelave, por në atë rast nuk lejohet hapje në ato fasada;
- Ngjitja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit të jetë max. 1.20 m;
- Qasja në Kompleksi me ndërtesë individuale banimor / shtëpi familjare planifikohet të jetë përmes parcelës kadastrale, nr.1555-0, 844-0, 848-0, 845-0, 1553-0 dhe 847-0 ZK Bërnice Epërme me pronar/posedues Daut Zuka, e konfirmuar përmes aktit noterial "Deklaratë – Pëlqim", përpiluar te Noter Ramadan Bunjaku në Prishtinë, me Nr.Rend.9943/2019 dt.21.10.2019, me të cilin akt i lartë cekuri ndër të tjerash deklaroi se *"se nëpër parcelat kadastrale nr. 155-0, 844-0, 848-0, 845-0, 1553-0, 924/2 dhe 920-0 ZK Bërnice e Epërme lejon hapjen e rrugës me gjerësi prej 7m' në interes dhe llogari të Nazmi Çitakut nga Fshati Bajçinë Komuna e Podujevës"*;
Qasja në kompleks kalon edhe përmes pjesëve të parcelës kadastrale nr.1495-0 ZK Bërnice e Epërme me pronar / posedues P.SH. Ujërat, për të cilin kërkuesit para aplikimit për leje ndërtimi do të prezantojnë pëlqim nga pronari / poseduesi ;
- Për çdo njësi individuale banimore / shtëpi familjare, të planifikohet një vend parkim, në kuadër të ndërtesës apo kompleksit;
- Në kuadër të parcelave ndërtimore të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave;

VI. Bashkimi i parcelave kadastrale, nr. 954-0, 955-0, 959-0 dhe 973-0 ZK Bërnice e Epërme, do të realizohet sipas Planit të situacionit – "zgjidhjes urbane" dhe Manualit të bashkimit punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar "Geohorizont" nga Prishtina me licencës nr.54.

Andaj, Drejtoria e Urbanizmit jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe Manualit për bashkim.

Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve, dhe të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve dhe Manualit të bashkimit të punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar "Geohorizont" nga Prishtina me numër të licencës nr.54.

VII. Ndarja / parcelimi i parcelave kadastrale, nr.954-0, 955-0, 959-0 dhe 973-0 ZK Bërnice e Epërme, pas bashkimit të tyre dhe formimi i parcelave ndërtimore dhe asaj për infrastrukturë – rrugë, do të realizohet sipas projekt propozimit - Planit të situacionit / "zgjidhja urbane" dhe Manuali e ndarjes punuar nga kompania gjeodezike e licencuar.

Gjithashtu do të ndahet edhe parcela e formuar për rrugë sipas manualit të propozuar me nr.xxxxx-35 ZK Bërnice e Epërme do të evidentohet me destinim infrastrukturë – rrugë, si dhe parcelat kadastrale nr. 844-0, 845-0, 848-0, 847-0, 1553-0 dhe 1555-0 ZK Bërnice Epërme e pronar /posedues Daut Zuka, si dhe pjesa e parcelës kadastrale nr.1495-0 ZK Bërnice e Epërme, me pronar /posedues P.SH. Ujërat ;

Andaj, Drejtoria e Urbanizmit jep PËLQIM për ndarjen/parcelimin e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Manualit i ndarjes punuar nga kompania gjeodezike, dhe pas sigurimit të pëlqimit nga pronari/poseduesi i parcelës kadastrale nr.1495-0 ZK Bërnice e Epërme.

Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Ndarja e parcelave të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - "zgjidhja urbane" dhe Manualit për ndarje punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar "Geohorizont" nga Prishtina me licencës nr.54, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Kjo procedurë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

VIII. Kushti i përcaktuar në këtë paragraf, përcaktohet për:

- *Ndarjen e parcelave kadastrale nr.1555-0, 844-0, 848-0, 845-0, 1553-0 dhe 847-0 ZK Bërnice Epërme me pronar / posedues Daut Zuka nga Prishtina, bazuar në Ligjin Nr.2002/5 për themelimin e regjistrimit të regjistrit të drejtave të Pronës së Paluajtshme, duhet të shndërrohet në infrastrukturë rrugore;*
- *Sigurimin e pëlqimit për qasje përmes parcelës nga pronari/poseduesi i parcelës kadastrale nr.1495-0 ZK Bërnice e Epërme, P.SH. Ujërat, me gjerësi min. 7m' dhe ndarjen e saj;*
- *Me procedurën e bashkimit të parcelave kadastrale sipas paragrafit VI. të vendimit duhet edhe të harmonizohen sipërfaqet e parcelave kadastrale – tekstuale dhe grafike (të certifikatës së pronës dhe kopjes së planit), në të kundërtën obligohet Drejtoria e Urbanizmit të rishikoj kushtet ndërtimore;*

IX. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçe në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Paraprakisht duhet të sigurohet edhe pëlqimi parimor nga Ngrahorja e Qytetit sh.a. "Termokos" dhe PTK-ja.

X. Dokumentacioni ndërtimor / projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën V., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;

- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafo-stacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

XI. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 & 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të ri-mbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

XIII. Pagesa e kompensimit të ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale, nr. 954-0, 955-0, 959-0 dhe 973-0 ZK Bërnice e Epërme, që trajtohet me këto kushte ndërtimore në bazë të certifikatave së njësisë kadastrale, dhe të përshkruara në pikën 1 të paragrafit III. të vendimit të kushteve ndërtimore, janë të evidentuara si toka bujqësore: "Arë e klasit 4", "Mal i klasit 4" dhe "Livadh i klasit 2", andaj paraprakisht kërkohet që të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konformë nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e parcelave kadastrale - tokave bujqësore, të cilave do ti ndërrohet destinimi, përcaktohen bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelave ndërtimore të përcaktuara sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqet në total prej **S=15,120.00m²**.

Këto sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Gjithashtu, parcela e formuar për rrugë të parcelave ndërtimore, sipas manualit të propozuar me nr.xxxxx-34 ZK Bërnice e Epërme do të evidentohet me destinim infrastrukturë – rrugë, dhe Drejtoria e Kadastrit ta regjistroj si "rrugë" në përputhje me Ligjit Nr.2002/5 për themelimin e regjistrimit të regjistrimit të drejtave të Pronës së Paluajtshme.

Kompensim / pagesa për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, dhe ajo e infrastrukturës teknike, do të realizohet në Drejtorinë e Kadastërit të Komunës së Prishtinës, pas ndarjes së kësaj parcele dhe në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XIV. Pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës & tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kërkuesit / pronarët, Nazmi Çitaku dhe Jashar Fazliu nga Prishtina, rr."Eqrem Qabej", BLL-III/9 me kërkesën, 05nr.350/02 - 240634/19, dt.01.10.2019, kanë ri-aplikuar dhe kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare gjegjësisht Kompleksi - **Lagja "Green Hill"** me **33 shtëpi** të Tipit: **"T1" – 6 shtëpi** me S+P, **"T2" – 15 shtëpi** me S+P, **"T3" – 5 shtëpi** me P+1 dhe **"T4" – 7 shtëpi** me S+P, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 – 170831/19 dt.17.07.2019 dhe kërkesës për ri-aplikim 05nr.350/02 - 240634/19, dt.01.10.2019 si dhe plotësuar me shkresën 05nr.350/02 – 240634/19/1 dt.25.10.2019, dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dhe trajtuar dokumentacionin dhe provat si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë: Kopjen e planit dhe Certifikatat e njësive kadastrale për parcelat kadastrale nr. 954-0, 955-0, 959-0, 973-0 ZK Bërnice e Epërme, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër;
- Vërtetimin e obliguesit tatimor në emër të Nazmi Çitaku nr.170776/19 dt.17.07.2019;
- Vërtetimin e obliguesit tatimor në emër të Jashar Fazliu nr.170776/19 dt.17.07.2019;
- Fotokopjet e letërnjoftimeve të të lartë cekurve;
- Informim nga Plani Zhvillimor Urban "Prishtina 2012-2022"-PZHU, 04nr.350/01 – 0307342/17 dt.22.12.2017, lëshuar nga DPSZHQ të Komunës së Prishtinës;
- Incizimi Gjeodezik Gjendjes Faktike, punuar nga "GeoHorizont"sh.p.k. nga Prishtina, me licencë nr.54;
- Fotokopjen e pa vërtetuar të Kontratë për Qiranë e Tokës Pyjore nr.400 dt.07.02.2019, e lidhur në mes të Agjencia Pyjore e Kosovës në kudër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Qeverisë së Kosovës dhe Nazmi Çitakut nga Prishtina;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Pëlqim" nr.399 dt.07.02.2019, dhe me Ref:KE-79/19 dt.07.02.2019, e lëshuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës në kudër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Qeverisë së Kosovës;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Marrëveshje në mes bashkëpronarëve për investime të përbashkëta" në mes të Nazmi Çitakut dhe Jashar Fazliut nga Prishtina, përpiluar te Avokat – B.I. Fahri Sadriu në Prishtinë;
- Projekt propozimin konceptual, hartuar nga "GM Architecture"sh.p.k. nga Prishtina;
- Afishja "Njoftim Publik" dt.12.11.2019 dhe 17.11.2019, të leshur nga kjo drejtori;
- Vendimi 05nr.350/02 – 170831/19 dt.06.09.2019, mbi refuzimin e kërkesës 05nr.350/02-170831/19 dt.17.07.2019, për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Aktin noterial "Deklaratë-Pëlqim" Nr.Rend.9943/2019 dt.21.10.2019, përpiluar te Noter Ramadan Bunjaku në Prishtinë;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Aplikacion për pëlqim uhor" nr.6362/19, 6363/19 dhe 6364/19 të gjitha të datës dt.24.10.2019, drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore;
- Manualin e bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale nr. nr. 954-0, 955-0, 959-0, 973-0 ZK Bërnice e Epërme, parcelave nr.1555-0, 844-0, 848-0, 845-0, 1553-0 dhe 847-0 ZK Bërnice Epërme,

